

Ripajisja me pasaportë biometrike jashtë vendit

Përshkrimi

Ripajisja e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike jashtë shtetit, kur humbet pasaporta ose bëhet e pavlefshme.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Denoncimi për humbjen e dokumentit në organet policore të vendit ku ka ndodhur humbja, e legalizuar ose apostiluar, për rastet e humbjes;
- 2) Pasaporta e pavlefshme, për raste të bërjes së dokumentit të pavlefshëm;
- 3) Letërnjoftim elektronik dhe/ose
- 4) Pasaportë e modelit të vjetër dhe/ose
- 5) Leje për drejtim automjeti, model elektronik (model i ri) dhe/ose
- 6) Dokument tjetër i vlefshëm me fotografi lëshuar nga vendi pritës;
- 7) Kuponi për pasaportën ose konferma për kryerjen e pagesës në llogarinë e përfaqësisë

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personale dhe verifikimi i identitetit
- 2) Konfirmimi i të dhënave me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- 3) Marrja e fotos dixhitale
- 4) Skanimi dhe marrja e shenjave të gishtërinjve
- 5) Depozitimi i nënshkrimit elektronik

Tarifa e shërbimit dhe afati

- 1) Greqi, Itali :130 euro,
- 2) Bruksel: 170 euro,
- 3) Angli: 144 paund,
- 4) Zvicër: 204 franga,
- 5) SHBA: 240\$

Afati i shërbimit është 28 ditë.

Zyra

- 1) Ambasadat e RSH: Athinë; Romë; Londër; Bernë.
- 2) Konsullatat e Përgjithshme: Selanik; Milano.
- 3) Zyra konsullore: Nju Jork.

Shënime

E njëjta procedure ndiqet kur duhet zëvendësuar pasaporta e dëmtuar ose kur janë plotësuar të gjithë fletët e saj.